



**KOMUNA E PRISHTINËS**  
**RAPORT MUJOR**

Drejtoria	<b>Drejtoria e Rinisë dhe Sportit (DRS)</b>
Periudha raportuese	<b>Korrik, 2020</b>
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fitim Rexha

**1. PËRMBLEDHJE - Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.**

Edhe në Drejtorinë e Rinisë dhe Sportit ka ndikuar situata me pandeminë Covid -19, gjë që ka ndikuar në mos realizimin e shumë aktiviteteve të planifikuara, si nga DRS, po ashtu edhe në bashkëpunim me OJQ dhe klube sportive dhe federata sportive, si dhe me qytetarë të lagjeve të ndryshme. Megjithatë, DRS nuk i ka ndërprerë aktivitetet e në shërbim të qytetarëve dhe klubeve sportive të qytetit asnjëherë. DRS nuk ka asnjë të infektuar me Covid -19 deri në momentin e raportimit.

Drejtoria e Rinisë dhe Sportit ka pranuar 17 lëndë gjatë muajit korrik, prej tyre 16 janë ende në proces, ku kemi 14 ankesa lidhur me subvencionet, kurse 1 lëndë është miratuar, e lënda e miratuar është regjistrimi i shkollës së futbollit “Marigona”.

*Të dhëna statistikore për Drejtorinë e Rinisë dhe Sportit:*

<b>Lëndët e pranuarat- Korrik 2020</b>	<b>Në Proces</b>	<b>Miratuarat- Vendime- Pëlqime</b>	<b>Refuzuara</b>	<b>Lëndë dhe raporte nga klubet sportive</b>
<b>17</b>	16	01	00	00

Gjatë muajit korrik 2020, pas përfundimit të procesit intervistues nga departamenti i Burimeve Njerëzore, kanë filluar punën:

- |                    |                   |                 |            |
|--------------------|-------------------|-----------------|------------|
| 1. Bardh Avdiu,    | zyrtar për Rini,  | data e fillimit | 01.07.2020 |
| 2. Granit Makolli, | zyrtar për Sport, | data e fillimit | 01.07.2020 |

**2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA - Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj.**

*DRS gjatë muajit korrik 2020, ka bërë dorëzimin e subvencioneve të aprovuara nga Komisioni vlerësues për pagesë në Drejtorinë e Financave; ku kanë aplikuar 234 klube/OJQ nga fusha e Sportit dhe Rinisë, kurse janë përkrahur nga Komisioni vlerësues 122 aplikime.*

*Lëndët e dorëzuara në Drejtorinë e Financave, sipas datave:*

<i>Data</i>	<i>Numri i lëndëve të dërguara</i>	<i>Fusha e veprimtarisë</i>
15.07.2020	15	Sport
16.07.2020	15	Rini
20.07.2020	12	Sport
22.07.2020	69	Sport
22.07.2020	07	Rini
23.07.2020	03	Sport
29.07.2020	01	Sport

Gjithashtu, gjatë muajit korrik DRS është angazhuar në realizimin e planit buxhetorë të DRS-së:

**Kodi 49808 është dorëzuar në Prokurim për procedim të mëtutjeshëm.**

Kodet që kanë të bëjnë me fushat sportive, janë bërë paramasat për ndërtimin e katër terreneve sportive në katër lokacione të ndryshme të komunës sonë, siç edhe përshkruhet në kodet e mëposhtme, dhe ka mbetur vetëm edhe finalizimi i paramasave për dorëzimin në Prokurim. Ne besojmë se dorëzimi i këtyre kodeve në Prokurim do të bëhet deri në fund të kësaj jave, 15 gusht 2020, e më së largu javën e ardhme deri më 20 gusht 2020.

Sa i përket Kodit 49784, është duke u realizuar nga Kryetari, Kabineti dhe DRS.

KODI	KAPITALET	BUXHETI	ALOKIM ET	MBETJA
49814	Ndërtimi i fushës sportive të SHF "Ilmi Rakovica" (Modeli i fushave në lagjen "Dardania"	50,000.00	10,000.00	50,000.00
49784	Ndërtimi i sallës shumëfunktionale në komunën e Prishtinës	1,110,000.00		1,110,000.00
89412	Ndërtimi i fushave sportive në komunën e Prishtinës	250,000.00	50,000.00	250,000.00
49791	Shtigje për ecje dhe vrapim, shënjimi dhe infrastruktura të ngjashëm me shtegun	140,000.00	50,000.00	140,000.00
49799	Zhvillimi i aktiviteteve sportive dhe rinore: kupa, medalje etj..	50,000.00	10,000.00	50,000.00
49808	Shënjimi i fushave sportive dhe këndeve të lodrave me tabela njoftuese	5,000.00		5,000.00
	Gjithsej	1,605,000.00	120,000.00	1,605,000.00

**3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA - Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtoria juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë.**

- Përfundimi i lëndëve me dokumente konkrete;
- Bashkëpunimi me Zyrën për Investime Kapitale lidhur me ndërtimin e fushave sportive në:
  - Lagjen "Emshiri",
  - Te SHMU "Ilmi Rakovica",
  - Fshatin Llukar,
  - Fshatin Bardhosh;
- Takimet e rregullta të zyrtarëve shqyrtues me grupin profesional- kolegjiun për lëndë konkrete;
- Takime të shumta me qytetarë, klube të sportit dhe organizata rinore për konsultime;
- Takim në NPB me Dritëro Çardakun, së bashku me Ardianin dhe Kushtrimin, bisedë për përmirësime në disa fusha sportive të qytetit dhe për bashkëpunime të tjera;
- Vlen të përmenden takimet me presidentin e Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani, me zyrtarët e KF "Prishtina" dhe KF "Flamurtari" etj.;
- Takim me zyrtarët e Federatës së Automobilizmit të Kosovës lidhur me bashkëpunimin, me qëllim të përfitimit të projekteve nga FIA të destinuar për Kosovën;
- Përgjigje në kërkesa të ndryshme sa i përket punës së Drejtorisë.

#### **4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR - Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues.**

- Është duke vazhduar projekti (110,991.30) për ndërtimin e dy terreneve sportive;
  - Lagja e Universitetit – terren sportiv për tenis, i përfunduar mbi 50%. Gjatë implementimit kanë hasur në probleme me kablo nëntokësore të rrymës, të cilat nuk po largohen me kohë nga përgjegjësit e KEDS-it.
  - Lagja “Arbëria” – terreni sportiv për futboll, basketboll dhe volejball është pothuajse në përfundim e sipër, 95% i kryer. Shkaqet e vonësive kanë qenë moti dhe pandemia, por ndoshta edhe një papërgjegjësi e menaxherëve të projektit.
- Po punohet që sa më shpejt të kryhen projektet dhe paramasat, me qëllim të fillojmë procedura e tenderimit të fushave sportive:
  - Lagjen “Emshiri”,
  - Tek SHMU “Ilmi Rakovica”,
  - Fshatin Llukar,
  - Fshatin Bardhosh.
- Gjatë tërë kohës janë duke u identifikuar pengesat në zbatim të planeve.

##### **4.1.2. Buxhetin e planifikuar dhe atë të shpenzuar për periudhën raportuese**

Edhe pse raportet tregojnë se DRS nuk ka buxhet të shpenzuar, i tërë buxheti i DRS është në procedura e sipër, duke filluar nga subvencionet, ndërtimi i fushave sportive, si dhe përfundimi i projekteve.

##### **4.1.3 Takimet me palë**

Kanë vazhduar takimet me palë, të martave dhe të enjteve, me përjashtime edhe ditëve tjera, sipas nevojës, gjithmonë duke zbatuar rekomandimet nga Komuna, IKSHP dhe institucionet tjera relevante

##### **5. Takimet me institucione të tjera**

- Takim me KOK-në.

##### **6. Diskutime publike/takimet me qytetarë**

**6.1.1 Takim me qytetarët e Bardhoshit, Kodrës së Trimave, Hajvalisë dhe grupe të ndryshme nga Sporti dhe Rinia,**

**6.1.2. Lëndët e pranuar dhe të kryera 17-1**

## 7. Takime të tjera

- Takim në mes të DRS-së dhe DK-së;

8. *SFIDAT - Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë.*

Sfidë për DRS mbetet edhe më tutje çështja e implementimit të projekteve në realizim e sipër, si dhe të atyre të cilat janë planifikuar. DRS nuk është e kënaqur me menaxherët e projekteve, si dhe me pjesën kur projektet dorëzohen në Prokurim.

Sfidë për DRS mbetet krijimi i një plani të veprimit për Sport dhe Rini.

9. *REKOMANDIME - Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të Drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.*

- Të mundësohen trajnime ose vizita zyrtare të stafit sa i përket procedurës së menaxhimit me objekte dhe fusha publike nga sporti.

10. *AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES - Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues:*

- Vazhdimi me shqyrtimin e lëndëve (aprovim, refuzim);
- Procedimi i lëndëve, sipas afatit kohor të paraparë me ligj;
- Analizat dhe listimi i aktiviteteve të nevojshme përgatitore për sistemin online për klubet/OJQ-të e Prishtinës;
- Konsultime me palë në lidhje me projektet;
- Aktivitete rreth avancimit të shërbimit të informimit të klubeve/OJQ-ve për procedurat e aplikimit dhe regjistrimit në Komunë;
- **Dorëzimi i projekteve për terrenet sportive, si dhe shtigjet për vrapim në Prokurim për procedim të mëtutjeshëm.**

*TË TJERA - Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.*